

Data 09.04.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Aktivitete kulturore:Eksod 99, 1-Qershori, Dita e Bjeshkeve,
Turizmi Malor Shishtavec, Festa Tradicionale e Gjallices, Festa Tradicionale e Rrunave”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):79952100-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,916,667(dy milion e nenteqind e gjashtembedhjete mije e
gjashteqind e gjashtedhjete e shtate) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *(i ndryshuar)*, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kukes** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10;**

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të L.PP(i ndryshuar), nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP(i ndryshuar), nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 a)Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

b)Kopje e vertetuar të balanceve të tre viteve të fundit (2022, 2023 dhe 2024) të paraqitur pranë Administratës Tatimore të konfirmuar nga ky autoritet. **ku të paktën në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP(i ndryshuar), si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

- 2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqitet kontrata e lidhur e shoqëruar me vërtetimin përkatës të lëshuar nga enti publik për realizimin e suksesshëm të kontratës.

Ose

- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të së përllogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqese **një deklaratë**, me anë të së cilës të deklarojë se do të ofrojë shërbimin në afatet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **4 (kater) punonjës**, me kohë të plotë pune, për periudhën **2 (dy)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi : Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 4 (kater) punonjës, për të paktën 2 muajt e fundit, me kohë të plotë pune, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së (i ndryshuar), ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së shërbimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së (i ndryshuar) dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në ligjin 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore Në Republikën E Shqipërisë” I Ndryshuar në Kreun IX, neni 79.

2.3.4 (Makineri, Pajisje)

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet, makineritë dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Mjetet	Sasia	Gjendja
Automjet për transportin e grupit	2 mjete	Pronësi/me qera/ose huapërdorje

artistik		
Automjet per transportin e gjerave materiale dhe mallrave(ushqime)	1 mjet	Pronësi/me qera/ose huapërdorje

.Për Automjetin në pronësi mjetet duhet të paraqiten dokumentat si me poshtë:

a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit;

b) leje qarkullimi;

c) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm)

2.Për Automjetin e marre me qera duhet të paraqiten dokumentat si me poshtë:

a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij nga ana e qeradhenesit.

b) leje qarkullimi;

c) siguracionin e mjetit,(i vlefshëm);

d) Kontraten e qerese e vlefshme gjate gjithë periudhes se zbatimit te sherbimeve.

3.Për Automjetin e marre me huapërdorje duhet të paraqiten dokumentat si me poshtë:

a)dokumentit që vërteton regjistrimin e tij nga ana e huadhenesit.

b) leje qarkullimi;

c)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm);

d) Kontraten e huadhenies e vlefshme gjate gjithë periudhes se zbatimit te sherbimeve

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik (i ndryshuar)” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 41 pika 4 ç / “Kërkesat të veçanta për kontratat e sherbimeve” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) parashikohet: “mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Njesia e Prokurimit